





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA VENDORE KORÇË

JAS AM  
Nr. 155  
Data: 12.01.2024  
H. Radomi

Nr. 50/10 Prot.

Korçë, më 10.01.2024

Lënda: Kërkesë për publikim.

**BASHKISË MALIQ** ✓

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ Për Kadastrën“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 “ Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që “ Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së” dhe “ Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së”, për sa më sipër kërkojmë:

- Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.
- Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.
- Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet.

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:

- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfituese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Iglli Radomi

STAMP  
dt 12.01.2024  
[Signature]

DREJTORI  
Stavri Mushka  
(me urdhër dhe delegim)  
ZV/DREJTORI  
Iglli Radomi

Nr. 11 Prot



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Korçë

Date: 2024/01/10 10:19:04 +02:00

Korçë | [www.ashk.gov.al](http://www.ashk.gov.al), email: [info@ashk.gov.al](mailto:info@ashk.gov.al)